

RAPORT FINANCIAR VJETOR

“Banka Amerikane e Investimeve” Sh.a., NIPT J91725007P

PJESA 1 – Hyrje

DEKLARATA E EMETUESIT

Me siguri të plotë, deklarojmë se i gjithë informacioni dhe të dhënat e paraqitura në këtë raport financiar janë të sakta dhe korrekte dhe se nuk është hequr asnjë informacion apo e dhënë që do të cënonte saktësinë dhe plotësinë e informacionit,

nënshkruar nga Z.Andi Ballta Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv



PËRGJEGJËSIA PËR INFORMACIONIN E PËRFSHIRË NË RAPORT

Emetuesi pranon përgjegjësinë për informacionet dhe të dhënat që përmban raporti. Informacioni është në përputhje me faktet dhe nuk lë jashtë asnjë të dhënë që do të cënonte vlefshmërinë e tij. Kur përdoren të dhëna nga burimet e palëve të treta, informacioni në fjalë riprodhohet saktësisht dhe emetuesi është në gjendje të sqarojë informacionin e publikuar nga kjo palë e tretë dhe se nuk është lënë jashtë asnjë fakt që do ta bënte të pasaktë apo çorientues informacionin e riprodhuar.

Autoriteti nuk e ka verifikuar saktësinë dhe korrektësinë e informacionit që përmban kjo deklaratë.

PJESA 2 – Të dhënat kryesore të emetuesit

- | | | |
|-----|--|--|
| 1 | Emri dhe forma juridike e emetuesit | “Banka Amerikane e Investimeve” Sh.a |
| 1.1 | Adresa e plotë (Rruga, ndërtesa, apartamenti, kodi postar, qyteti, shteti) | Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, H.1, Njësia Bashkiake 10, Kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri, e regjistruar pranë Regjistrat Tregtar në përputhje me vendimin Nr. 20830, datë 12 Shkurt 1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. |
| 1.2 | Adresa e postës elektronike dhe e faqes së internetit | info@abi.al / www.abi.al |

1.3	Numri i Identifikimit i Personit Juridik (NIPT)	J91725007P
1.4	Ligji në bazë të të cilit ushtron aktivitetin emetuesi	Banka Amerikane e Investimeve Sh.a zotëron licence bankare, në përputhje me Ligjin Nr.9662, Për bankat në Republikën e Shqipërisë", datë 18 dhjetor 2006, Rregulloren e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me Vendim Nr. 14, datë 11.03.2009, "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", version i integruar", e ndryshuar si dhe me legjislacionin në fuqi në Republikës së Shqipërisë.
1.5	Vendi i themelimit të emetuesit	Tiranë, Shqiperi

PJESA 3 – Të dhëna të përgjithshme

1	Periudha e raportimit	31 Dhjetor 2025
2	Numri i punonjësve (në fund të periudhës së raportimit)	802
3	Raporti i konsoliduar, i audituar	Pasqyrat Financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 te audituara
4	Emrat e shoqërive të kontrolluara (në bazë të standardeve SNRF) me selitë e tyre	Shoqëria ka pjesëmarrje kontrolluese ne filialet me poshte: • "ABI Invest Sh.a." 100% te aksioneve te shoqerive , Seli ne Tirane Shqiperi • "ABI Broker Sh.a." 100% te aksioneve te shoqerive, Seli ne Tirane Shqiperi • I.F.J.B ABI Sh.a ne Kosove. 60% te aksioneve te shoqerise Seline ne Prishtine Kosove
5	Formulari i kontabilitetit (po/jo) dhe emri i shoqërisë së kontabilitetit	Jo/ pa aplikueshme
6	Personi i kontaktit (emri, mbiemri, numri i telefonit, adresa e postës elektronike)	Znj. Vilsa Lika adrese elektronike (vluka@abi.al) Znj. Ariola Cela (Nr Cel:0696084099, e-mial: ariolacela@noafin.al)
7	Shoqëria e auditimit dhe auditori i certifikuar (emri dhe mbiemri)	Grant Thornton Albania sh.p.k., shoqëri audituese për periudhën financiare të mbyllur më 31 dhjetor 2024, përfaqësuar nga auditori i certifikuar z. Kledian Kodra. RSM Albania sh.p.k., shoqëri audituese për periudhën financiare të mbyllur më 31 dhjetor 2025, përfaqësuar nga auditori i certifikuar z. Fatian Devija.

PJESA 4 – Bilanci ne mije LEK

Kodi ADP	Zëri	31/12/2024	31/12/2025
	Aktivët		
	Paraja, balancat e parasë në bankat		
1	qendrore dhe depozitat pa afat (nga 2 në 4)	14,705,338	13,209,243
2	Mjete monetare në arkë	7,840,680	6,040,440
3	Paraja dhe balancat në bankat qendrore	6,864,658	7,168,803
4	Depozita të tjera pa afat		
	Aktivët financiarë të mbajtura për tregtim		
5	(nga 6 në 9)	-	-
6	Derivativët		
7	Instrumentet e kapitalit		
8	Titujt e borxhit		
9	Huatë dhe paradhëniet		
	Aktivët financiarë jo të tregtueshme me		
	vlërë të drejtë të detyrueshme përmes		
	fitimit		
10	ose humbjes (nga 11 në 13)	-	-
11	Instrumentet e kapitalit		
12	Titujt e borxhit		
13	Huatë dhe paradhëniet		
	Aktivët financiarë me vlerë të drejtë përmes		
14	fitimit ose humbjes (15 + 16)	-	-
15	Titujt e borxhit		
16	Huatë dhe paradhëniet		
	Aktivët financiarë me vlerë të drejtë përmes		
	të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (nga		
17	18 në 20)	24,181,542	38,863,672
18	Instrumentet e kapitalit		
19	Titujt e borxhit		
20	Huatë dhe paradhëniet	24,181,542	38,863,672
	Aktivët financiarë me kosto të amortizuar		
21	(22 + 23)	95,709,568	100,916,697
22	Titujt e borxhit	36,883,810	31,977,098
23	Huatë dhe paradhëniet	58,825,758	68,939,599
24	Derivativët - kontabiliteti mbrojtës		
	Ndryshimet e vlerës së drejtë të elementeve		
	mbuluese në portofolin mbrojtës nga rreziku		
25	I normës së interesit		
	Investime në filiale, njësi ekonomike të		
26	kontrolluara bashkërisht dhe me pjesëmarrje	120,500	215,456
27	Aktivët e trupëzuara	2,302,799	2,495,193
28	Aktivët e patrupëzuara	123,633	191,129
29	Aktivët tatimore		

30	Aktive të tjera	3,579,395	4,059,358
	Aktivet afatgjata dhe grupet e klasifikuara për nxjerrje jashtë përdorimit të mbajtura për t'u shitur		
31	Aktive gjithsej (1 + 5 + 10 + 14 + 17 + 21 + nga 24 deri në 31)	140,722,775	159,950,748
	Pasivet		
	Pasivet financiare të mbajtura për t'u tregtuar (nga 34 deri në 38)	-	-
34	Derivativët		
35	Fitimet nga ulja e çmimit (short positions)		
36	Depozitat		
37	Titujt e emetuar të borxhit		
38	Pasive të tjera financiare		
	Pasivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (nga 40 deri në 42)	-	-
40	Depozitat		
41	Titujt e emetuar të borxhit		
42	Pasivet e tjera financiare		
	Pasivet financiare të matura me kosto të amortizuar (nga 44 deri në 46)	124,618,635	138,428,976
44	Depozitat	100,510,426	118,701,114
45	Titujt e emetuar të borxhit	1,706,974	2,745,609
46	Pasive të tjera financiare	22,401,235	16,982,253
47	Derivativët - kontabiliteti mbrojtës		
	Ndryshimet e vlerës së drejtë të elementeve mbuluese në portofolin mbrojtës nga rreziku I		
48	normës së interesit		
49	Provigjonet	56,438	20,240
50	Pasivet tatimore	58,998	218,860
51	Kapitali aksionar i kthyeshëm sipas afatit		
52	Pasive të tjera	3,614,218	5,210,527
	Pasivet e përfshira në grupet e klasifikuara për nxjerrje jashtë përdorimit të mbajtura për t'u shitur		
53	Pasive gjithsej (33 + 39 + 43 + nga 47 deri në 53)	128,348,289	143,878,603
	Kapitali neto		
55	Kapitali fillestar	3,450,935	4,182,773
56	Prim i lidhur me aksionin		
57	Instrumente të kapitalit neto përveç kapitalit		
58	Instrumente të tjera të kapitalit neto		
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të akumuluar		
59			

60	Fitim i pashpërndarë	3,236,127	5,687,995
61	Rezerva rivlerësimi	434,869	552,746
62	Rezerva të tjera	5,252,555	5,648,631
63	(–) Aksione të thesarit Fitimi ose humbja që u ngarkohet pronarëve të		
64	shoqërisë mëmë		
65	(–) Dividendët e ndërmjetëm		
66	Interesat e pakicës [interesat jokontrolluese]		
67	Kapitali neto gjithsej (nga 55 deri në 66)	12,374,486	16,072,145
68	Kapitali neto dhe pasivet gjithsej (54 + 67)	140,722,775	159,950,748

PJESA 4 – Pasqyra e fitimit ose humbjes ne mije Lek

Kodi ADP	Zëri	31/12/2024	31/12/2025
1	Të ardhurat nga interesi	7,423,594	9,972,529
2	(Shpenzimet nga interesi)	(2,128,011)	(2,929,234)
3	(Shpenzimet për kapitalin e kthyeshëm sipas afatit)	-	-
4	Të ardhurat nga dividendi	-	-
5	Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	606,188	1,217,709
6	(Shpenzimet nga tarifat dhe komisionet)	(147,235)	(670,528)
7	Fitimet ose (-) humbjet nga çregjistrimi i aktiveve dhe pasiveve financiare që nuk janë matur me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, neto		
8	Fitimet ose (-) humbjet nga aktivet dhe pasivet		
9	Fitimet ose humbjet nga aktivet financiare jo për tregtim me vlerë të drejtë të detyruar përmes fitimit ose humbjes, neto		
10	Fitimet ose (-) humbjet nga aktivet dhe pasivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, neto		
11	Fitimet ose (-) humbjet nga kontabiliteti mbrojtës, neto		
12	Ndryshimet e kursit të këmbimit [fitim ose (-) humbje], neto	222,138	290,727
13	Fitimet ose (-) humbjet nga çregjistrimi i aktiveve financiare, neto		
14	Të ardhura të tjera operative	459,760	163,558
15	(Shpenzime të tjera operative)		
16	Të ardhurat operative gjithsej, neto (1 – 2 – 3 + 4 + 5 – 6 + nga 7 deri në 14 – 15)	6,436,434	8,044,761
17	(Shpenzimet administrative)	(2,155,189)	(3,193,301)
18	(Kontributet me mjete monetare në bordet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe në skemat e garancisë së depozitave)		
19	(Amortizimi)	(306,639)	(440,245)
20	Fitimet ose (-) humbjet nga modifikimi, neto		
21	(Provigjonet ose (-) anulimi i provigjoneve)	(197,000)	254,742
22	(Zhvlerësimi ose (-) anulimi i zhvlerësimit të aktiveve financiare që maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes)		
23	(Zhvlerësimi ose (-) anulimi i zhvlerësimit të investimeve në filiale, sipërmarrje të përbashkëta dhe me pjesëmarrje)		

24	(Zhvlerësimi ose (-) anulimi i zhvlerësimit të aktiveve të aktiveve jofinanciare)		
25	Emri i mirë negativ i regjistruar në fitim ose humbje		
26	Përqindja e fitimit ose (-) humbjes së investimeve në filiale, sipërmarrje të përbashkëta dhe me pjesëmarrje, të llogaritura duke përdorur metodën e kapitalit neto		
27	Fitimi ose (-) humbja nga aktivet e qëndrueshme dhe grupet e nxjerra jashtë përdorimi të mbajtura për t'u shitur, që nuk kualifikohen si veprimtari jovicijuese		
28	Fitimi ose (-) humbja përpara tatimit nga veprimtaritë vijuese (16 – 17 – 18 + 19 + 20 nga 21 deri në 24 + nga 25 deri në 27)	3,777,606	4,665,957
29	(Shpenzimet tatimore ose (-) të ardhurat nga fitimi ose humbja nga veprimtaritë vijuese)	(571,939)	(748,562)
30	Fitimi ose (-) humbja pas tatimit nga veprimtaritë vijuese (28 – 29)	3,205,667	3,917,395
31	Fitimi ose (-) humbja pas tatimit nga veprimtaritë jovicijuese (31 – 32)	-	-
32	Fitimi ose (-) humbja përpara tatimit nga veprimtaritë jovicijuese	-	-
33	(Shpenzimet tatimore ose (-) të ardhurat nga veprimtaritë jovicijuese)		
34	Fitimi ose (–) humbja për vitin (30 + 31; 35 + 36)	3,205,667	3,917,395
35	I ngarkohet interesit të pakicës [interesa jokontrrolluese]		
36	U ngarkohet pronarëve të shoqërisë mëmë		
Pasqyra e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse			
37	Të ardhurat ose (-) humbjet për vitin aktual		
38	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (39 +51)	496,019	117,877
39	Zërat që nuk do të riklasifikohen në fitim ose humbje (nga 40 deri në 46) + 49 + 50)	-	-
40	Aktivitet e trupëzuara		
41	Aktivitet e patrupëzuara		
42	Fitimet ose (-) humbjet aktuariale nga përfitimet e përcaktuara të planeve të pensionit		
43	Aktivitet e qëndrueshme dhe grupet e nxjerra jashtë përdorimi të klasifikuara si të mbajtura për t'u shitur		
44	Përqindja e të ardhurave dhe shpenzimeve të tjera të njohura të subjekteve e llogaritur duke përdorur metodën e kapitalit		
45	Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve të kapitalit të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse		

	Fitimet ose (-) humbjet nga kontabiliteti mbrojtës i instrumenteve të kapitalit me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, neto		
46	Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve të kapitalit të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse [element mbulues]		
47	Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve të kapitalit të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse [instrument mbulues]		
48	Ndryshimet në vlerën e drejtë të pasiveve me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes që u		
49	Tatimi mbi të ardhurat që lidhet me zërat që nuk do të riklasifikohen		
50	Zërat që mund të riklasifikohen në fitim ose humbje (nga 52 deri në 59)	496,019	117,877
51	Mbrojtja e investimeve neto në veprimtaritë jashtë vendit [pjesa efektive]		
52	Përkthimi i monedhës së huaj		
53	Mbrojtje të fluksit të mjeteve monetare [pjesa efektive]		
54	Instrumente mbrojtëse [elemente jo të përcaktuara]		
55	Instrumentet e borxhit me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	496,019	117,877
56	Aktivitet e qëndrueshme dhe grupet e nxjerra jashtë përdorimit të mbajtura për t'u shitur		
57	Përqindja e të ardhurave të tjera të njohura dhe shpenzimeve për investime në investime, filiale, sipërmarrje të përbashkëta dhe në pjesëmarrje		
58	Tatimi mbi të ardhurat që lidhet me zërat që mund të riklasifikohen në fitim ose (-) humbje		
59	Të ardhurat gjithëpërfshirëse gjithsej për vitin aktual (37 + 38; 61 + 62)	496,019	117,877
60	I ngarkohen interesit të pakicës [interesi i kontrollues]		
61	U ngarkohen pronarëve të shoqërisë mëmë		
62			

PJESA 6 – Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare ne mije LEK

Kodi ADP	Zëri	31/12/2024	31/12/2025
	Veprimtaritë e shfrytëzimit – metoda e drejtpërdrejtë		
1	Interesat e marra dhe të arkëtueshme të ngjashme		
2	Tarifat dhe komisionet e marra		
3	(Interesat e paguara dhe shpenzime të ngjashme)		
4	(Tarifat dhe komisionet e paguara)		
5	(Shpenzimet e paguara operative)		
6	Fitimet/humbjet neto nga instrumentet financiare me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së fitimit ose humbjes		
7	Arkëtime të tjera		
8	(Shpenzime të tjera)		
	Veprimtaritë e shfrytëzimit - metoda e tërthortë		
9	Fitimi/(humbja) përpara tatimit	3,777,606	4,665,957
	Sistemime:		
10	Zhvlerësimi dhe provigjonet	284,412	(168,771)
11	Amortizimi	306,639	440,245
12	Te ardhura nga interesat	(5,295,583)	(7,043,295)
13	Shpenzime interesi		
14	Zëra të tjerë jomonetarë	(222,138)	(290,727)
	Ndryshimet në aktive dhe pasive nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
15	Depozitat në Bankën e Shqipërisë	205,280	107,924
16	Depozitat me institucionet financiare dhe huadhëniet për institucionet financiare	704,489	944,813
17	Huatë dhe paradhëniet për klientë të tjerë	(9,540,806)	3,119,180
18	Tituj dhe instrumente të tjera financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	3,461,701	(12,060,010)
19	Tituj dhe instrumente të tjera financiare të mbajtur për t'u tregtuar		
20	Tituj dhe instrumente të tjera financiare me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së fitimit ose humbjes, të patregtuar		
21	Tituj dhe instrumente të tjera financiare me vlerë të drejtë të detyruar përmes pasqyrës së fitimit ose humbjes		

22	Tituj dhe instrumente të tjera financiare me kosto të amortizuar	404,384	301,125
23	Aktive të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
24	Depozitat nga institucionet financiare	(5,214,419)	(14,636,380)
25	Llogaritë e transaksioneve të klientëve të tjerë	7,088,684	12,220,917
26	Depozita kursimi të klientëve të tjerë		
27	Depozitat me afat të klientëve të tjerë		
28	Derivatë të pasiveve financiare dhe pasive të tjera të mbajtura për t'u tregtuar		
29	Pasive të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	494,303	1,263,858
30	Interesat e marra nga veprimtaritë e shfrytëzimit	7,547,909	9,916,270
31	Dividendët e marrë nga veprimtaritë e shfrytëzimit [metoda e tërthortë]	-	
32	Interesi i paguar nga veprimtaritë e shfrytëzimit [metoda e tërthortë]	(2,102,480)	(2,924,433)
33	(Tatimi i paguar mbi të ardhurat)	(571,939)	(890,302)
	Total	1,328,042	(5,033,629)
Veprimtaritë e investimit			
34	Arkëtimet në mjete monetare nga shitja/pagesat për blerjen e aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara	114,877	(95,450)
35	Arkëtimet në mjete monetare nga shitja/pagesat për blerjen e investimeve në filiale, në pjesëmarrje dhe në sipërmarrje të përbashkëta	(59,665)	(36,314)
36	Arkëtimet në mjete monetare nga shitja/pagesat për blerjen e titujve dhe instrumenteve të tjera financiare që mbahen deri në maturim	1,918,475	4,906,712
37	Dividendët e përftuar nga veprimtaritë e investimit	-	
38	Arkëtime/pagesa të tjera nga aktivitetet e investimit	-	887,221
39	Fluksi neto i mjeteve monetare nga veprimtaritë e investimit (nga 35 deri në 39)	1,973,687	5,662,169
Veprimtaritë e financimit			
40	Rritja/(ulja) neto në huatë e marra nga veprimtaritë e financimit		
41	Rritja/(ulja) neto në titujt e emetuar të borxhit		543,714
42	Rritja/(ulja) neto në instrumentet e kapitalit të klasës 2	-	
43	Rritja në kapitalin aksionar		
44	(Dividendët e paguar)	(2,642,883)	(2,972,494)
45	Arkëtime/(pagesa) të tjera nga veprimtaritë e financimit		
46	Fluksi i mjeteve monetare neto nga aktivitetet e financimit (nga 41 deri në 46)	(2,642,883)	(2,428,780)

47	Rritja/(ulja) neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare (34 + 40 + 47)	658,846	(1,800,240)
48	Mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare në çelje të periudhës	7,181,833	7,840,680
49	Efektet e luhatjeve të kursit të këmbimit të mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare	-	-
50	Mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare në fund të periudhës (48 + 49 + 50)	7,840,679	6,040,440

PIESA 7 – Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto në mije LEK

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore dhe të tjera	Rezerva e vlerës së drejtë	Fitim i akumuluar	Totali
	Lek '000	Lek '000	Lek '000	Lek '000	Lek '000
Gjendja më 1 janar 2024	3,450,935	5,246,364	(61,149)	2,679,534	11,315,683
Fitimi i vitit	-	-	-	3,205,667	3,205,667
Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë	-	-	496,019	-	496,019
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	496,019	3,205,667	3,701,686
Veprimet me aksionarët të regjistruara direkt në kapital	-	-	-	(2,642,883)	(2,642,883)
Shpërndarje dividendi	-	6,191	-	(6,191)	-
Rritje e rezervës ligjore	-	6,191	-	(2,649,074)	(2,642,883)
Totali i kontributeve dhe i shpërndarjeve ndaj aksionarëve	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	3,450,935	5,252,555	434,869	3,236,127	12,374,486
Fitimi i vitit	-	-	-	3,917,395	3,917,395
Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë	-	-	117,877	-	117,877
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	117,877	3,917,395	4,035,272
Veprimet me aksionarët të regjistruara direkt në kapital	-	-	-	(2,972,494)	(2,972,494)
Shpërndarje dividendi	-	322,892	-	(322,892)	-
Rezerva rregullatore	731,838	73,184	-	1,829,859	2,634,881
Reserva e bashkimit NOA	731,838	396,076	-	(1,465,526)	(337,613)
Totali i kontributeve dhe i shpërndarjeve ndaj aksionarëve	4,182,773	5,648,631	552,746	5,687,995	16,072,145
Gjendja më 31 dhjetor 2025					

PJESA 8 – Shënimet

Emri i emetuesit: Banka Amerikane e Investimeve Sh.a. ("Banka" ose "American Bank of Investments" ose "ABI"),
Numri personal i identitetit (OIB): NIPT J91725007P
Periudha e raportimit: 31 Dhjetor 2025
Pasqyrat financiare hartohen në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Pasqyrat financiare të veçanta të Bankës janë përgatitur mbi bazën e kostos historike me përjashtim të instrumenteve të borxhit me vlerë të drejtë përmes të ardhurave gjithëpërfshirëse, të cilat maten me vlerë të drejtë, aktivet e mbajtura për shitje, të cilat maten me vlerën e drejtë minus koston për ti shitur, dhe inventarit, i cili matet me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme

Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare individuale paraqiten në Lek Shqiptar ("LEK"), e cila është edhe monedha funksionale e raportimit. Të gjitha shifrat janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, përveçse kur shprehet ndryshe.

Standarte të reja apo të rishikuara ose interpretime

Standarte dhe interpretime të reja të cilat nuk janë ende efektive

Standardet dhe ndryshimet e mëposhtme janë publikuar, por ende nuk kanë hyrë në fuqi në datën e raportimit dhe nuk janë zbatuar para kohe nga Banka:

- Ndryshimet në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare (Ndryshime në IFRS 9 dhe IFRS 7) (në fuqi nga 1 janari 2026)
- IFRS 18 "Paraqitja dhe Shpalosja në Pasqyrat Financiare" (në fuqi nga 1 janari 2027)
- IFRS 19 "Shoqëritë bijë pa përgjegjësi publike: Shpalosjet" (në fuqi nga 1 janari 2027)

Banka nuk i ka zbatuar para kohe këto standarde, pasi ato nuk janë ende të detyrueshme dhe vazhdojnë të jenë subjekt i udhëzimeve për zbatim, zhvillimeve në interpretim dhe, aty ku është e aplikueshme, proceseve lokale të miratimit. Shtyrja e zbatimit i mundëson Bankës të sigurojë një implementim të qëndrueshëm dhe të fortë, në përputhje me praktikën e industrisë dhe kërkesat rregullatore.

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, nuk ka standarde, ndryshime apo interpretime të tjera të reja të publikuara nga IASB ose IFRIC që janë relevante për Bankën dhe që janë zbatuar para kohe. Drejtimi synon të zbatojë të gjitha standardet dhe ndryshimet e aplikueshme në periudhën që fillon më ose pas datave të tyre përkatëse të hyrjes në fuqi.

Politikat kontabël të përcaktuara më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme nga Institucioni për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

a) Kombinimet e biznesit

Banka zbaton metodën e blerjes në kombinim e biznesit. Detyrimi i transferuar nga Banka për të marrë kontrollin e një filiali të kontrolluar llogaritet si shuma e vlerës së drejtë të aktiveve të

transferuara, detyrimeve të kryera dhe interesave të kapitalit datën e blerjes së pasurive të transferuara, pasiveve të lindura dhe interesave të kapitalit neto lëshuar nga Banka, e neto të emetuara nga Banka, ku përfshihet vlera e drejtë e çdo aktivi ose pasivi që rrjedh nga një marrëveshje kontigjente. Kostot e blerjes njihen mbi baze konstatimi. Aktivet e blera dhe pasivet e marra maten me vlerën e tyre të drejtë të datës së blerjes.

b) Filiali dhe konsolidimi

Filialet janë entitete të kontrolluara nga Banka. Banka përgatit pasqyrat financiare të veçanta në përputhje me SNRF-të. Filialet mbahen me kosto në pasqyrat financiare të veçanta. Banka nuk përgatit pasqyrat financiare të konsoliduara, pasi Mëma, Tranzit Sh.a. përgatit pasqyrat financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të. Informacioni mbi interesin për subjektet e tjera paraqitet në Shënimin 18.

c) Investime në pjesëmarrje

Investimi në një pjesëmarrje është një entitet mbi të cilin Banka ka ndikim pozitivisht. Ndikim i rëndësishëm është fuqia për të marrë pjesë në vendimet e politikës financiare dhe operative të investuarit, por nuk është kontroll ose kontroll i përbashkët mbi këto politika.

Konsideratat e bëra në përcaktimin e ndikimit të rëndësishëm ose të kontrollit të përbashkët janë të ngjashme me ato të domosdoshme për të përcaktuar kontrollin mbi filialet. Investimi i Bankës në shoqërinë e tij llogaritet me kosto. Në pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë mëmë të Bankës, Tranzit Sh.a., investimi gjithashtu kontabilizohet sipas metodës së kostos.

Pas humbjes së ndikimit të rëndësishëm mbi pjesëmarrjen, Banka mat dhe një çdo investim të mbartur në vlerën e tij të drejtë. Çdo diferencë midis vlerës kontabël neto të pjesëmarrjes pas humbjes së ndikimit të rëndësishëm dhe vlerës së drejtë të investimit të mbartur dhe të ardhurave nga nxjerrja jashtë përdorimit njihen në fitim ose humbje.

d) Transferimi i interesit të kontrollit në entitete nën kontroll të përbashkët

Në mungesë të udhëzimeve specifike në IFRS, transaksionet që përfshijnë entitete nën kontroll të përbashkët kontabilizohen në përputhje me hierarkinë e përshkruar në IAS 8 "Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet".

Drejtimi ka zgjedhur të aplikojë metodën e vlerës kontabël (pooling of interests) për transferimet e interesave të kontrollit në entitete që në fund kontrollohen nga i njëjti aksionar. Sipas kësaj metode, nuk ka shpërblim të transferuar nga blerësi të njësisë së blerë, si rrjedhojë pasuritë dhe detyrimet e përfituara njohën dhe bashkuan të entiteti mbijetues vlerat e tyre kontabël të regjistruara në pasqyrat financiare individuale të entitetit të transferuar.

Aktivitet dhe detyrimet e njësisë së përthithur transferohen në aktivet dhe detyrimet e njësisë përthithëse (mbijetuese), ndërsa elementet e kapitalit alokohen ndërmjet kapitalit të regjistruar (kapitalit themeltar), rezervës ligjore dhe fitimeve të pashpërndara.

Pasqyrat financiare pasqyrojnë rezultatet e kombinimit të entiteteve nga data kur të drejtat substanciale të kontrollit filluan të ushtrohen në mënyrë efektive, siç është përcaktuar nga drejtimi.

e) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë

të huaj në datën e raportimit janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në atë datë. Fitim ose humbja nga kursi i këmbimit mbi zërat monetare është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të vitit, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë vitit, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura për këmbimin e balancave në monedhë të huaj për vitin 2025 dhe 2024 janë si më poshtë (në Lekë):

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
1 USD	82.46	94.26
1 EUR	96.77	98.15
1 GBP	114.86	118.16

Ndërsa kurset mesatare vjetore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 të konvertuar në Lekë janë si më poshtë:

	Viti 2025	Viti 2024
1 USD	86.80	93.04
1 EUR	94.50	100.70
1 GBP	111.90	118.69

f) Interesat

Norma efektive e interesit

Të ardhurat nga interesat regjistrohen duke përdorur metodën e normës efektive të interesit ("NEI") për të gjithë instrumentet financiare të matur me koston e amortizuar, instrumentet financiare të dizenuar më Vlerë të Drejtë në fitim humbje ("VDFH"). Të ardhurat nga interesi për instrumentet financiare që sipas SNRF 9 maten me Vlerë të Drejtë në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ("VDATGJ"), klasifikohen si të vlefshme për shitje ose mbajtur deri në maturim, gjithashtu regjistrohen duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma, me të cilën skontohej egzaktesisht pagesat e vlerësuara të ardhshme të mjeteve monetare ose arkëtimet përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar, ose kur është e përshtatshme, për periudhën më të shkurtër, duke arritur në vlerën kontabël neto të aktivit financiar.

NEI (dhe për këtë dhe kosto e amortizuar e një aktivi) përllogaritet duke marrë në konsideratë ndonjë skontim apo prim në blerje, komisionet dhe kosto të tjera që janë pjesë integrale e NEI-t. Banka njeh të ardhurat nga interesat duke përdorur një normë kthimi që përfaqëson vlerësimin më të mirë të një normë konstante kthimi gjatë jetës së pritshme të huasë. Për këtë njeh efektin e normave të ndryshme të interesit të aplikuar në faza të ndryshme, dhe karakteristika të tjera të ciklit të jetës së produktit (duke përfshirë parapagimet, gjobat dhe komisionet).

Nëse pritjet në lidhje me flukset e parave në aktivin financiar rishikohen për arsye të tjera nga rreziku i kredisë, rregullimi regjistrohet si një rregullim pozitiv ose negativ i vlerës kontabël të aktivit në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar me një rritje ose ulje të interesit të ardhura.

Rregullimi amortizohet në vijim nëpërmjet të ardhurave nga operacionet bankare në pasqyrën e fitim humbjeve dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

Interesat dhe të ardhura të ngjashme

Banka përllogarit të ardhurat nga interesat duke aplikuar NEI mbi vlerën bruto të aktivit financiar, që nuk janë aktive të zhvlerësuara. Kur një aktiv financiar zhvlerësohet dhe për këtë arsye quhet si "Faza 3", Banka i përllogarit të ardhurat nga interesat duke aplikuar normën efektive të interesit

mbi vlerën neto të aktivitetit financiar. Nëse aktivi financiar përmirësohet dhe nuk është më i zhvlerësuar, Banka e ndryshon llogaritjen e të ardhurave nga interesi mbi vlerat bruto të tij.

Për aktivet financiare të blera apo të krijuara të zhvlerësuar ("POCI"), Banka përllogarit të ardhurat nga interesat duke përllogaritur NEI-in të rregulluar dhe më pas duke e aplikuar atë normë mbi koston e amortizuar të aktivitetit.

NEI i rregulluar është norma e interesit, e cila në njohjen fillestare, skanton flukset e ardhshme të parashikuara (duke përfshirë dhe humbjen kreditore) në vlerën e amortizuar të aktivitetit POCI.

g) Tarifat dhe komisioni - Të ardhurat nga shërbimet bankare të klientët

Banka fiton të ardhura nga tarifa dhe komisioni nga një gamë e larmishme shërbimesh që u ofron klientëve të saj. Tarifat dhe të ardhurat nga komisioni dhe shpenzimet që janë përbërëse e normës efektive të interesit për një aktiv ose detyrim financiar përfshihen në matjen e normës efektive të interesit. Tarifat e shërbimit dhe komisionet për të cilat Banka merr përsipër një detyrim të performancës ndaj klientëve, njihen si të hyra bankare dhe llogariten sipas SNRF 15 Të ardhurat nga kontrata me klientët. Termat dhe kushtet e shërbimit të Bankës (kontratat) zakonisht nuk përfshijnë detyrime të shumëfishta të performancës, të përfshira nën një konsideratë, rrjedhimisht nuk ka ndonjë gjykim të rëndësishëm për shpërndarjen e çmimit të transaksionit.

Për më tepër, shërbimet bankare të ofruara nga banka kanë një kohëzgjatje jo më shumë se një vit ose rinovohen në bazë vjetore (për shembull, mirëmbajtja e llogarisë). Rrjedhimisht, Banka ka përdorur një shfrytëzues praktik të standardit dhe nuk ka nevojë të paraqesë informacione për shumën e përgjithshme të çmimit, në lidhje me pjesën e pakënaqur të detyrimeve të performancës.

Kënaqësia e detyrimeve të performancës kryhet ose në një pikë të kohës kur me të ardhurat nga komisioni njihet kur shërbimi është ekzekutuar dhe transferuar të klienti, ose me kalimin e kohës kur nga Banka kryen shërbimin për një periudhë të dakordësuar dhe klienti e konsumon atë si shërbimi është duke u kryer, dhe të ardhurat njihen gjatë periudhës në fjalë..

Të ardhurat nga komisionet mund të ndahen në tre kategoritë e mëposhtme:

- *Të ardhurat nga komisionet të fituara nga shërbimet që sigurohen gjatë periudhës*

Komisionet e fituara për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhës njihen gjatë kësaj kohe. Këto komisione përfshijnë komisione për mirëmbajtje llogarie, kartë dhe shërbim E-banking.

- *Të ardhura nga komisionet të fituara nga shërbimet financiare dhe nga ekzekutimi i transaksioneve në një kohë të caktuar*

Këtu përfshihen Të ardhurat nga komisioni të njohura në një kohë të caktuar zakonisht kanë të bëjnë me transaksionin. Ato përfshijnë tarifa nga porositë e pagesës dhe transferimit të klientëve, dhe shërbimet e tjera bankare të ofruara. Tarifat e shërbimeve të huasë që nuk janë pjesë e normës efektive të interesit, përfshirë komisionet e sigurimeve, njihen gjithashtu kur shërbimi kryhet dhe transferohet të klienti. Këto tarifa ose përbërës të tarifave që janë të lidhura me një performancë të caktuar dhe njihen si shërbime të lidhura.

Tarifat e tjera dhe të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet linden në shërbimet financiare të operuara nga Banka dhe njihen kur shërbimi përkatës sigurohet ose pranohet.

h) Shpenzimet tatimore

Shpenzimet tatimore përbëhen nga tatimi aktual dhe ai i shtyrë, që njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes së periudhës me përjashtim të rasteve që lidhen me zëra që njihen direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual është shuma e pagueshme ose e arkëtueshme për të ardhurat e tatueshme ose për shpenzimet për periudhën, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim për tatimin e pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual e pagueshme ose e arkëtueshme është vlerësuesi më i mirë i shpenzimit të pritshëm taksativ për t'u paguar ose arkëtuar që reflekton pasiguri lidhur me tatim fitimin, nëse ka. Ajo matet duke përdorur normën tatimore në fuqi ose të miratuar parimisht në datën e raportimit.

(ii) Tatimi i shtyre

Tatimi i shtyrë njihet mbi diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime fiskale. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të aktiveve ose detyrimeve në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as në kontabilitet as në fitimin ose humbjen e tatueshme. Aktivet tatimore të shtyra njihen mbi humbjet tatimore të mbartura, të drejtat tatimore të mbartura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme duke konsideruar fitime të ardhshme të tatueshme, kundrejt të cilave të mund të përdoren.

Aktivitet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është i mundur realizimi i përfitimit tatimor respektiv; reduktimet e tilla sistemohen, kur probabiliteti i fitimit të tatueshëm në të ardhmen përmirësohet. Aktivitet tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në masën e fitimit të ardhshëm të tatueshëm që do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ato mund të përdoren.

Tatimi i shtyre llogaritet me normat e tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme në momentin e rimarrjes, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

(iii) Ekspozimi tatimor

Në përcaktimin e vlerës së tatimit aktual dhe tatimit të shtyrë, Banka merr në konsideratë efektin e situatave të pasigurta nga ku mund të lindin detyrime shtesë në lidhje me taksat. Ky vlerësim bazohet në supozime dhe parashikime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh mbi ngjarje të së ardhmes. Informacione të reja të mundshme mund të bëjnë Bankën të ndryshojë gjykimin e saj përsa i përket saktësisë së detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime të mundshme në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimin për tatimin në periudhën në të cilën ky konstatim do të bëhet.

i) Instrumentet financiare

(i) Data e njohjes

Banka njeh fillimisht huatë dhe paradhëniet dhënë klientëve, depozitat, letrat me vlerë të emetuara dhe detyrimet e varura në datën në të cilën janë origjinuar. Blerjet e zakonshme dhe shitja e aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit në të cilën Banka angazhohet për të blere apo shitur aktivin. Të gjithë aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Banka bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Kreditë dhe paradhëniet dhënë klientëve njihen kur fondet janë transferuar në llogaritë e klientëve. Banka njeh detyrimet ndaj klientëve kur fondet janë transferuar në Bankë.

(ii) Njohja fillestare e instrumenteve financiare

Klasifikimi i instrumenteve financiare në njohjen fillestare varet nga termat e tyre kontraktuale dhe modeli i biznesit për të menaxhuar këto instrumente. Instrumentet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë, me përjashtim të rasteve të aktiveve dhe detyrimeve financiare të regjistruar si aktive që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ("VDFH"), për cilat kostot e transaksionit shtohen apo zbriten nga kjo vlerë.

Llogaritë e arkëtueshme maten me çmimin e transaksionit. Në rastet kur vlera e drejtë e një instrumenti financiar në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, Banka regjistron fitimin ose humbjen e Ditës së parë, siç përshkruhet më poshtë.

(iii) Fitimi ose humbja e Ditës së parë

Në rastet kur vlera e drejtë e një instrumenti ndryshon nga vlera e drejtë në njohjen fillestare dhe vlera e drejtë bazohet në teknika vlerësimi që përdorin vetëm inputet e vëzhgueshme në transaksionet e tregut, Banka njeh diferencën midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë në të ardhurat neto të tregtimit. Në ato raste kur vlera e drejtë bazohet në modele për të cilat disa nga inputet nuk janë të vëzhgueshme, diferenca midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë shtyhet në kohë dhe njihet vetëm në fitim ose humbje kur inputet bëhen të vëzhgueshme ose kur instrumenti çregjistrohet.

(iv) Kategoritë e matjes së aktiveve dhe detyrimeve financiare

Banka klasifikon të gjitha aktivet e saj financiare në bazë të modelit të biznesit për menaxhimin e aktiveve dhe si dhe kushteve kontraktuale të aktiveve të matura me:

- koston e amortizuar
- VDATGJ

Detyrimet financiare, përveç angazhimeve të huave dhe garancive financiare, maten me kosto të amortizuar ose me VDFH kur mbahen për tregtim ose përcaktimi i vlerës së drejtë është i aplikueshëm.

Huatë dhe paradhëniet për bankat, huatë dhe paradhëniet për klientët dhe investimet financiare me kosto të amortizuar

Banka vlerëson huatë dhe paradhëniet për bankat, klientët dhe investime të tjera financiare vetëm me kosto të amortizuar nëqoftëse të dy kushtet e mëposhtme plotësohen:

- Aktivet financiare mbahen me një model biznesi me qëllimin për të mbledhur flukse

monetare kontraktuale.

- Kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar japin në datat e specifikuara flukse monetare të cilat përbëhen vetëm nga pagesa e principalit dhe interesat për shumën e papaguar të tij.

Detajet e këtyre kushteve përshkruhen më poshtë.

Përcaktimi i modelit të biznesit

Banka përcakton modelin e saj të biznesit në nivelin që reflekton më mirë mënyrën se si menaxhon grupet e aktiveve financiare për të arritur objektivin e saj të biznesit. Modeli i biznesit i Bankës nuk vlerësohet bazuar në instrumente individuale, por në portofole të grupuara. Vlerësimi i modelit të biznesit bazohet në skenarë të pritshëm, pa marrë në konsideratë skenarët në "rastin e stresit". Nëse flukset e mjeteve monetare pas njohjes fillestare realizohen në një mënyrë të ndryshme nga pritshmëritë fillestare të Bankës, Banka nuk ndryshon klasifikimin e aktiveve të mbetura financiare të mbajtura në atë model biznesi, por përfshin informacion të tillë gjatë vlerësimit të aktiveve financiare të sapo origjinuara ose ato të blera në vazhdim.

Testi SPPI

Si një hap i dytë i procesit të klasifikimit, Banka vlerëson kushtet kontraktuale të aktiveve financiare për të identifikuar nëse ata përmbushin testin SPPI. "Principal" për qëllim të këtij testi përcaktohet si vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare dhe mund të ndryshojë gjatë jetës së aktivitetit financiar (për shembull, nëse ka shlyerje të principalit ose amortizimin e primit / skontos). Elementët më të rëndësishëm të interesit në kuadër të marrëveshjes së huadhënies janë zakonisht konsiderata për vlerën kohore të parasë dhe rrezikut të kredisë. Për të bërë vlerësimin SPPI, Banka zbaton gjykimin dhe shqyrton faktorët relevante si monedha në të cilën është shprehur aktivi financiar dhe perioda për të cilën është përcaktuar norma e interesit.

Në të kundërt, kushtet kontraktuale që paraqesin një ekspozim më pak se minimumi ndaj rreziqeve ose paqëndrueshmëri në flukset monetare kontraktuale që nuk kanë lidhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, nuk krijojnë flukse kontraktuale të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit mbi tepricën e huasë. Në raste të tilla, aktivi financiar duhet të matet në VDFH.

Instrumentet e borxhit në VDATGJ

Banka i vlerëson investimet e tjera financiare në VDATGJ nëse të dy kushtet e mëposhtme përmbushen:

- Instrumenti i mbajtur brenda një modeli biznesi, objektivi i të cilit arrihet duke mbledhur flukset monetare kontraktuale dhe nga shitja e aktiveve financiare
- Kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar përmbushin testin SPPIs

Instrumentet e borxhit në VDATGJ janë matur më pas me vlerën e drejtë në fitimet dhe humbjet që vijnë si rezultat i ndryshimit të vlerës së drejtë të njohur në ATGJ. Të ardhurat nga interesi dhe fitimet dhe humbjet nga këmbimi i huaj njihen në fitim ose humbje në të njëjtën mënyrë si për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar. Llogaritja HKP për instrumentet e borxhit shpjegohet në shënimin 4.d Kur Banka mban më shumë se një investim në të njëjtën siguri, ato konsiderohen të disponueshme në bazën hyrje e parë dalje e parë. Nga çregjistrimi,

fitimet ose humbjet kumulative të njohura më parë në ATGJ janë riklasifikuar nga ATGJ në fitim ose humbje.

Instrumentet e kapitalit në VDATGJ

Pas njohjes fillestare, Banka zgjedh herë pas here të klasifikojë në mënyrë të pakthyeshme disa nga investimet e saj të kapitalit si instrumente të kapitalit në VDATGJ, kur ato plotësojnë përkufizimin e përcaktimit të kapitalit sipas *SNK 32 Instrumentet Financiare: Prezantimi* dhe nuk mbahen për tregtim. Një klasifikim i tillë përcaktohet mbi bazën instrument pas instrumenti.

Fitimet dhe humbjet nga këto instrumente të kapitalit nuk riciklohen kurrë në fitim. Dividendët njihen në fitim ose humbje si të ardhura të tjera operative kur është vendosur e drejta e pagesës, përveçse kur Banka përfiton nga të ardhurat e tilla si rikuperimi i një pjese të kostos së instrumentit, në këtë rast, fitimet e tilla regjistrohen në ATGJ. Instrumentet e kapitalit në VDATGJ nuk i nënshtrohen një vlerësimi për zhvlerësimin.

Banka nuk ka ndonjë instrument të tillë më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024.

Garancitë financiare, letrat e kreditit dhe angazhimet e huave të pashfrytëzuara

Banka lëshon garanci financiare, letra krediti dhe angazhimet të huave.

Garancitë financiare njihen fillimisht në pasqyrat financiare të veçanta si zëra jashtë bilancit dhe janë paraqitur në angazhimet dhe eventualitetet me vlerën e drejtë, duke qenë primi i marrë. Pas njohjes fillestare, detyrimi i Bankës nën secilën garanci matet më të lartën mes shumës së njohur fillimisht duke zbritur amortizimin kumulativ të njohur në pasqyrën e të ardhurave, dhe - një provizion HKP siç përcaktohet në shënimin 4.j.

Primi i marrë njihet në pasqyrën e të ardhurave në Të ardhurat neto nga komisionet me metodën lineare përgjatë jetës së garancisë.

Angazhimet e huave të pashfrytëzuara janë angazhime për të cilat, gjatë kohëzgjatjes së angazhimit, Bankës i kërkohet t'i sigurojë klientit një kredi me kushte të paracaktuara. Kontratat e garancisë financiare janë në fushën e kërkesave të HKP-së.

Vlerat nominale kontraktuale të garancive financiare, letrave të kreditit dhe angazhimeve të huave të pashfrytëzuara, ku kredia për të cilën është rënë dakord është me kushtet e tregut, nuk regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar.

Vlerat nominale të këtyre instrumenteve bashkë me HKP-të përkatëse janë paraqitur në shënimin 12.

Riklasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

Banka nuk riklasifikon aktivet e saj financiare përtej njohjes së tyre fillestare, përveç situatave të jashtëzakonshme të përmendura në Standard.

Çregjistrimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

Çregjistrime nga modifikimet thelbësore të termave dhe kushteve

Banka çregjistron një aktiv financiar, të tilla si huaja për një klient, kur termat dhe kushtet janë rinegociuar në atë masë që, në thelb, bëhet një hua e re, me diferencën e njohur si fitim ose humbje nga çregjistrimi, deri në masën që një humbje nga zhvlerësimi nuk është regjistruar

ende. Huatë e reja të njohura klasifikohen si Faza 1 për qëllimet e matjes së HKP-ve, përveçse kur kredia e re, konsiderohet të jetë POCL. Gjatë vlerësimit nëse do të çregjistrohet një hua për një klient, ndër të tjera, Banka konsideron faktorët e mëposhtëm:

- Ndryshimi në monedhën e huasë
- Futja e një tipari të instrumentit të kapitalit
- Ndryshimi në kundërparti
- Nëse modifikimi është i tillë që instrumenti nuk do të përmbushë më kriterin e SPPI

Nëse modifikimi nuk rezulton në flukse të mjeteve monetare që janë në thelb të ndryshme, modifikimi nuk rezulton në çregjistrim. Bazuar në ndryshimet në flukset e mjeteve monetare të skontuara me NEI fillestar, Banka regjistron një fitim ose humbje modifikimi, në masën e paregjistruar të humbjes nga zhvlerësimi.

Për detyrimet financiare, Banka konsideron një modifikim si të konsiderueshëm bazuar në faktorët kualitativë dhe nëse rezulton në një diferencë ndërmjet vlerës aktuale të skontuar të rregulluar dhe vlerës kontabël të detyrimit financiar prej dhjetë përqind ose më shumë. Për aktivet financiare, vlerësimi bazohet në faktorë cilësorë.

Çregjistrime të tjera përveçse ato nga modifikimet thelbësore

Aktivitet financiar

Një aktiv financiar (ose, kur është e mundur, një pjesë e një aktivi financiar ose pjesë e një grupi të aktiveve financiare të ngjashme) çregjistrohet kur të drejtat për të marrë flukse monetare nga aktivi financiar kanë skaduar. Banka, gjithashtu çregjistron aktivin financiar nëse ka transferuar aktivin financiar si dhe transferimi kualifikohet për çregjistrim.

Banka ka transferuar aktivin financiar nëse dhe vetëm nëse:

- Banka ka transferuar të drejtat e saj kontraktuale për të marrë flukse monetare nga aktivi financiar; ose
- Ajo ruan të drejtat për flukset e mjeteve monetare, por ka marrë detyrimin për të paguar plotësisht flukset monetare të marra pa vonesa materiale për një palë të tretë nën një marrëveshje 'kalimtare'.

Marrëveshjet kalimtare janë transaksione ku Banka ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi origjinal"), por merr një detyrim kontraktual për të paguar këto flukse monetare në një ose më shumë njësi ekonomike ("përfituesit eventuale"), kur të tre kushtet e mëposhtme janë plotësuar:

- Banka nuk ka asnjë detyrim të paguajë shumat për përfituesit eventuale, përveç nëse ka arkëtuar shuma ekuivalente nga aktivi origjinal, duke përjashtuar paradhëniet afatshkurtra me të drejtën për rimarrjen e plotë të shumës së huasë plus interesin e përlogarit me normat e tregut.
- Banka nuk mund të shesë ose të vendosë si kolateral aktivin fillestar përveçse si siguri për marrësit eventuale.
- Banka duhet të dorëzojë çdo fluks parash që mbledh në emër të përfituesve eventuale

pa vonesë materiale. Gjithashtu, Banka nuk ka të drejtë të ri-investoje flukse të tilla të parasë, me përjashtim të investimeve në mjete monetare ose ekuivalente të parasë duke përfshirë interesin e fituar, gjatë periudhës midis datës së arkëtimit dhe datës së dërgesës së kërkuar për përfituesit eventuale.

Një transferim kualifikohet për çregjistrim vetëm nëse:

- Banka ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit; ose
- Banka nuk ka transferuar as ruajtur thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit, por ka transferuar kontrollin e aktivit.

Banka e konsideron kontrollin të transferuar nëse dhe vetëm nëse transferuesi ka aftësinë praktike për të shitur aktivin në tërësinë e tij për një palë të tretë të palidhur dhe është në gjendje ta ushtrojë atë aftësi në mënyrë të njëanshme dhe pa vendosur kufizime shtesë për transferimin.

Nëse Banka as nuk ka transferuar e as nuk mbajtur në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet dhe ka mbajtur kontrollin e aktivit, aktivi vazhdon të njihet vetëm në masën e përfshirjes së vazhdueshme të Bankës, rast në të cilin, Banka njih edhe një detyrim lidhur me të. Aktivet e transferuara dhe detyrimi i lidhur me të maten në një bazë që reflekton të drejtat dhe detyrimet që Banka ka mbajtur.

Përfshirja e vazhdueshme që merr formën e një garancie mbi aktivin e transferuar matet me vlerën me të ulët midis vlerës kontabël fillestare të aktivit dhe shumën maksimale të konsideratës që Bankës mund t'i kërkohej të paguajë.

Çregjistrime të tjera përveçse ato nga modifikimet thelbësore (vazhdim)

Nëse përfshirja e vazhdueshme merr formën e një opsioni të shkruar ose të blere (ose të dyja) në aktivin e transferuar, përfshirja e vazhdueshme matet me vlerën që Bankës t'i kërkohej të paguajë gjatë riblerjes. Në rastin e një kontrate me opsion të shkruar mbi një aktiv që matet me vlerë të drejtë, masa e përfshirjes së vazhdueshme të njësisë ekonomike është e limituar më të voglën e vlerës së drejtë dhe çmimit të ushtrimit të opsionit.

Detyrime financiare

Një detyrim financiar çregjistrohet kur detyrimi i lindur prej tij zbatohet, anulohet ose skadon.

Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet me një tjetër nga i njëjti huadhënës në kushte thelbësisht të ndryshme, ose kushtet e një detyrimi ekzistues ndryshohen në mënyrë thelbësore, zëvendësimi ose modifikim i tillë trajtohet si një çregjistrim i detyrimit fillestar dhe njohje e një detyrimi të ri. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar fillestar dhe vlerës së paguar njihet në fitim ose humbje.

j) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Vështrim i përgjithshëm i parimeve të HKP

Banka ka regjistruar një fond zhvlerësimi për humbjet e pritshme të kredisë për të gjitha huatë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit që nuk mbahen në VDFH, së bashku me angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare, në këtë pjesë të gjitha të quajtura si 'instrumente financiare'. Instrumentet e kapitalit nuk janë subjekt i zhvlerësimit sipas SNRF 9.

Fondi i zhvlerësimit HKP bazohet në humbjet e kredisë që pritet të lindin gjatë jetës së aktivitetit (humbja e pritshme e kredisë për jetë ose AGJHKP), përveç nëse nuk ka pasur rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga krijimi, rast në të cilin, fondi bazohet në humbjen e pritur të kredisë në 12 muaj (12mHKP).

Politikat e Bankës për të përcaktuar nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë janë paraqitur në Shënimin 12.

HKP 12-mujore është pjesa e AGJHKPs që përfaqëson HKP që rezulton nga ato ngjarje dështimi në instrumentet financiare që janë të mundshëm brenda 12 muajve pas datës së raportimit.

Të dy AGJHKP dhe 12mHKP janë llogaritur në baza individuale ose në bazë kolektive, në varësi të natyrës së portofolit të instrumenteve financiare.

Banka ka krijuar një politikë për të kryer një vlerësim, në fund të çdo periudhe raportuese, nëse rreziku i kredisë i nëse instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, duke marrë parasysh ndryshimin në rrezikun e dështimit që ndodh gjatë jetës së mbetur të instrumentit financiar.

Bazuar në procesin e mësipërm, Banka grumbullon kreditë e saj në Fazën 1, Fazën 2, Fazën 3 dhe POCl, siç përshkruhet më poshtë:

- Faza 1: Kur kreditë njihen për herë të parë, Banka njeh një zhvlerësim në bazë të 12mHKP. Kreditë e Fazës 1 gjithashtu përfshijnë kredi ku rreziku i kredisë është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Faza 2.

Faza 2: Kur një kredi ka shfaqur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga krijimi, Banka regjistron një fond për AGJHKP-te. Kreditë e Fazës 2 gjithashtu përfshijnë kredi, ku rreziku i kredisë është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Faza 3

- Faza 3: kreditë që konsiderohen të zhvlerësuara plotësisht. Banka regjistron një fond për AGJHKP
- POCl: Aktivitetet e blera ose të origjinuara të zhvlerësuara ("POCl") janë aktivitetet financiare që janë të zhvlerësuara që në njohjen fillestare. Aktivitetet POCl regjistrohen me vlerën e drejtë në njohjen fillestare dhe të ardhurat nga interesi njihen më pas në bazë të një NEI të rregulluar. HKP-të njihen ose rimerren vetëm në masën që ka një ndryshim pasues në humbjet e pritshme të kredisë. Aktivitetet e zhvlerësuara të kredisë të fituara në një kombinim biznesi nuk trajtohen si POCl.

Për aktivitetet financiare për të cilat Banka nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rikuperimin e të gjithë shumës së mbetur, ose një pjesë të saj, vlera kontabël bruto e aktivitetit financiar zvogëlohet. Ky konsiderohet një çregjistrim (i pjesshëm) i aktivitetit financiar.

Përlllogaritja e HKP-ve

Banka llogarit HKP-të në bazë të tre skenarëve të ponderuar me probabilitet e ndodhjes për të matur mungesat e flukseve të pritshme të arkëtimeve, të skontuara në një përafrim me NEI. Një mungesë e arkëtimeve të pritshme është diferenca midis flukseve të mjeteve monetare kontraktuale të pritshme dhe atyre që njësia ekonomike pret të arkëtojë.

Mënyra e llogaritjeve HKP është përshkruar më poshtë dhe elementët kryesorë janë si vijon:

- PD – Mundësia e dështimit ("PD") është një vlerësim i mundësisë së dështimit gjatë një horizonti kohor të dhënë. Një dështim mund të ndodhë vetëm në një kohë të caktuar

gjatë periudhës së vlerësimit, nëse aktivi nuk është çregjistruar më parë dhe vazhdon të qëndrojë në portofolin e Bankës.

- EAD – *Ekspozimi në Dështim ("EAD")* është një vlerësim për ekspozimin në një datë të ardhshme dështimi, duke marrë në konsideratë ndryshimet e pritshme në ekspozim pas datës së raportimit, duke përfshirë parapagimet e principalit dhe interesit, të skeduluara në kontratë apo jo, tërheqjet e pritshme në angazhime për financim të dhëna, dhe interesat nga pagesat e pakryera.
- LGD – *Dështimi në humbje ("LGD")* është një vlerësim i humbjes që del në rastin kur ndodh një dështim në një kohë të dhënë. Ai bazohet në diferencën midis flukseve kontraktuale të arkëtimeve dhe atyre që huadhënësi pret të arkëtojë.

Për llogaritjen e HKP-ve, Banka konsideron tre skenarë (bazë, optimist dhe pesimist).

Secila prej tyre shoqërohet me PD të ndryshme. Kur është e rëndësishme, vlerësimi i skenarëve të shumtë përfshin gjithashtu se si pritjet të rikuperohen huatë e papaguara, duke përfshirë dhe mundësinë që huatë do të kurohen dhe vlera e kolateralit ose shuma mund të merret nga shitja e aktivit.

Periudha maksimale për të cilën përcaktohen humbjet e kredisë është jeta kontraktuale e një instrumenti financiar, përveç nëse Banka ka të drejtën ligjore ta quajë atë më herët. Humbjet dhe lëshimet nga zhvlerësimi llogariten dhe shpalosen veçmas nga humbjet ose fitimet e modifikimit që llogariten si një rregullim i vlerës kontabël bruto të aktivit financiar

Mekanika e metodës HKP është përmbledhur më poshtë:

- *Faza 1:* 12m HKP llogaritet si pjesë e AGJHKP-ve që përfaqësojnë HKP-të që rezultojnë nga ngjarjet e dështimit të një instrumenti financiar që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit. Banka llogarit fondin e 12m HKP bazuar në pritshmërinë e një mospagimi që ndodh në 12 muajt pas datës së raportimit. Këto probabilitete të dështimit të pritur 12-mujor aplikohen mbi një EAD të parashikuar dhe shumëzohen me LGD-në e pritshme dhe të skontuar me një NEI të përafërsuar me origjinalin. Kjo llogaritje bëhet për secilin nga tre skenarët, siç është shpjeguar më sipër.
- *Faza 2:* Kur një hua ka shfaqur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga krijimi i saj, Banka regjistron një fond për AGJHKP. Mekanika është e ngjashme me ato të shpjeguara më sipër, duke përfshirë përdorimin e skenarëve të shumtë, por PD-të vlerësohen gjatë gjithë jetës së instrumentit. Mungesat e arkëtimeve të pritura të parave skontohen me një përafërsim të NEI-t origjinal.
- *Faza 3:* Për kreditë që konsiderohen si të zhvlerësuara, Banka njeh humbjet e pritshme gjatë gjithë jetës për këto kredi me llogaritje zhvlerësimi individual. Si parim, shuma e provizionit e kredive që zhvlerësohen në baza individuale llogaritet si diferenca ndërmjet shumës së mbetur papaguar të kredisë me a) shumën e kolateralit likuid dhe me b) shumën e vlerës aktuale të të gjitha flukseve monetare të ndryshme të zbritura me normën aktuale të interesit të kredisë;
- Aktivitet POCI janë aktive financiare që janë të zhvlerësuara që në njohjen fillestare. Banka njeh vetëm ndryshimet kumulative AGJHKPs që nga njohja fillestare, bazuar në tre skenarë me probabilitete, skontuar nga NEI i rregulluar.

Angazhimet e huave, letrat e kreditit dhe garancitë financiare:

Faktori i konvertimit të kredisë përdoret për të kthyer shumën e një linje krediti (pjesa e papërdorur) dhe shuma të tjera jashtë bilancit në një shumë të EAD. Është një supozim i modeluar, i cili përfaqëson një pjesë të çdo ekspozimi të papërdorur që pritet të tërhiqet para se të ndodhë një ngjarje e paracaktuar. Për secilin lloj produkti, faktori CCF për Bankën zbatohet si më poshtë:

- Letër garancia & letër krediti me maturitet të mbetur ≤ 1 vit = 20%
- Letër garancia & letër krediti me maturitet të mbetur > 1 vit = 50%
- Pjesa e papërdorur e kredive me afat = 0%
- Pjesa e papërdorur e overdrafteve = 20%
- Pjesa e papërdorur e kartave të kreditit = 20%

Instrumente të borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet ATGJ

HKP-ja për instrumente të borxhit të matura në VDATGJ nuk e zvogëlojnë vlerën kontabël të këtyre aktiveve financiare në pasqyrën e pozicionit financiar, e cila mbetet me vlerën e drejtë. Përkundrazi, një shumë e njëjtë me fondin, që do të krijohet nëse aktivet që maten me koston e amortizuar, njihet në ATGJ si një shumë zhvlerësimi e akumuluar, me një ngarkimin përkatës në fitim ose humbje. Humbja e akumuluar e njohur në ATGJ do të riciklohet në fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit të aktivit.

Aktive financiare të blera ose të gjeneruara të zhvlerësuara (POCI)

Për aktivet financiare POCI, Banka njeh vetëm ndryshimet kumulative në AGJHKP që nga njohja fillestare në fondin e humbjeve.

Informacion për ndodhi që priten të ndodhin

Në modelet e saj HKP, Banka mbështetet në një gamë të gjerë informatash të ardhshme, si inpute ekonomike, si:

- Rritja e Produktit të Brendshëm Bruto ("PBB")
- Normat e papunësisë
- Normat bazë të Bankës Qendrore
- Normat e inflacionit

Inputet dhe modelet e përdorura për llogaritjen e HKP-ve nuk mund të kapin gjithnjë karakteristikat e tregut në datën e pasqyrave financiare. Për të pasqyruar këtë, rregullime cilësore bëhen herë pas here si rregullime të përkohshme kur dallimet e tilla janë dukshëm materiale.

Përmirësimet e kredisë: vlerësimi i kolateraleve dhe garancitë financiare

Për të zvogëluar rrezikun e kredisë mbi aktivet financiare, Banka kërkon të përdorë kolaterale, kur është e mundur. Kolaterali vjen në forma të ndryshme, të tilla si para, letra me vlerë, letra krediti

/ garanci, pasuri të paluajtshme, arkëtime, inventarë dhe aktive të tjera jo-financiare. Kolaterali, përveç nëse merret në pronësi, nuk regjistrohet në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës.

Sidoqoftë, vlera e drejtë e kolateralit ndikon në llogaritjen e HKP-ve. Në përgjithësi vlerësohet, në minimum, në fillim dhe rivlerësohet në baza të shpeshta [periudha të ndryshme për lloje të ndryshme: Për shembull për kolaterale pasuri të paluajtshme, frekuenca është vjetore (ambiente biznesi) ose çdo 3 vjet (ambiente banimi)] . Sidoqoftë, disa kolaterale, për shembull, para ose letra me vlerë që kanë të bëjnë me kërkesat e marxhinalizimit, vlerësohen çdo ditë.

Me aq sa është e mundur, Banka përdor të dhëna të tregut aktiv për vlerësimin e aktiveve financiare të mbajtura si kolateral. Aktivet e tjera financiare që nuk kanë vlera të tregut të përcaktueshme lehtësisht, vlerësohen duke përdorur modele. Kolaterali jo financiar, siç është pasuria e paluajtshme, vlerësohet bazuar në të dhënat e paraqitura nga palët e treta siç janë vlerësuesit e brendshëm / të jashtëm të pasurive.

Nëse një kredi, si pjesë e kushteve të saj kontraktuale, është e garantuar nga një palë e tretë, Banka vlerëson HKP përkatëse bazuar në rrezikun e kombinuar të kredisë së garantuesit dhe palës së garantuar, duke reflektuar garancinë në matjen e humbjes në rast dështimi (LGD). Banka e konsideron garancinë financiare si përbërëse të kushteve kontraktuale të kredisë së garantuar, kur garancia është bere në të njëjtën kohë, ose brenda një kohë të shkurtër, pas avancimit të kredisë.

Garancitë që nuk janë parësore për kushtet e kontratës së kredisë, llogariten si njësi e veçantë e llogarive që i që janë subjekt i HKP-së.

k) Inventari (aktive të marra në zotërim)

Politika e Bankës përcakton nëse një aktiv i marrë në zotërim mund të përdoret për operacionet e brendshme ose duhet shitur. Aktivet e përcaktuara si të dobishme për operacionet e brendshme transferohen në kategorinë përkatëse të aktiveve me vlerën më të ulët midis vlerës së marrjes në pronësi ose vlerës kontabël të aktivit origjinal. Aktivet për të cilat shitja përcaktohet të jetë një opsion më i mirë transferohen në aktivet e mbajtura për shitje me vlerën e tyre të drejtë (nëse janë aktive financiare) dhe vlerën e drejtë pakësuar me koston për të shitur për aktivet jo-financiare në datën e rimarrjes, në përputhje me politikën e Bankës

Në rrjedhën e saj normale të biznesit, Banka angazhon agjentë të jashtëm për të rikuperuar fonde nga aktivet e rivlerësuar, përgjithësisht në ankand, për të shlyer borxhin e mbetur. Çdo fond i tepërt u kthehet klientëve / debitorëve. Si rezultat i kësaj praktike, pronat e banimit në proceset e riblerjes ligjore nuk janë regjistruar në bilanc.

l) Aktive afatgjata materiale per investim

Aktivitet Afatgjata Materiale të mbajtura për investim janë pasuri të mbajtura për të gjeneruar qira ose për rritje të vlerës kapital, ose të dyja, dhe kontabilizohen duke përdorur modelin e vlerës së drejtë.

Aktivitet Afatgjata Materiale të mbajtura për investim rishikohen vjetorisht, ku fitimet dhe humbjet e rezultuara njohën në të ardhurat ose humbjet e pasqyrës së fitimit dhe humbjes. Ato përfshihen në pasqyrën e pozicionit financiar sipas vlerave të tyre të drejtë (shënimi 16).

m) Fshirjet

Aktivitet financiarë fshihen pjesërisht ose tërësisht vetëm kur Banka nuk ka pritshmëri të arsyeshme për të rikuperuar një aktiv financiar në tërësi ose një pjesë të tij. Nëse shuma që duhet të fshihet është më e madhe se fondi i zhvlerësimit të akumuluar, diferenca fillimisht trajtohet si shtesë e këtij fondi, i cili më pas aplikohet ndaj vlerës kontabël bruto. Çdo rimarrje pasuese kreditohet të shpenzimi i humbjeve të kredisë.

n) Hua të ristrukturuara dhe modifikuara

Banka ndonjëherë bën lëshime ose modifikime të kushteve origjinale të kredisë si përgjigje ndaj vështirësive financiare të huamarrësit, në vend që të marrë në pronësi ose të zbatojë ndryshe mbledhjen e kolateralit.

Banka e konsideron një kredi të ristrukturuar kur lëshime të tilla ose modifikime janë dhënë si rezultat i vështirësive financiare aktuale ose të pritura të huamarrësit dhe Banka nuk do i kishte pranuar nëse huamarrësi do të ishte i shëndetshëm financiarisht. Treguesit e vështirësive financiare përfshijnë dështim në kovenantë ose shqetësimet e rëndësishme të ngritura nga Njësia e Menaxhimit të Riskut të Kredisë.

Ristrukturimi mund të përfshijë zgjerimin e marrëveshjeve të pagesës dhe marrëveshjen me kushtet e reja të kredisë. Pasi termat janë rinegociuar, çdo zhvlerësim matet duke përdorur NEI-n origjinal siç është llogaritur para modifikimit të termave. Është politikë e Bankës monitorimi i kredive të ristrukturuara për të siguruar që pagesat në të ardhmen të vazhdojnë të ndodhin.

Vendimet e çregjistrimit dhe klasifikimi midis Fazës 2 dhe Fazës 3 përcaktohen në bazë të kriterëve të paracaktuara. Nëse këto procedura identifikojnë një humbje në lidhje me një kredi, ajo shpalolet dhe menaxhohet si një aktiv i zhvlerësuar i Fazës 3 derisa të arkëtohet, periudha e provës të përfundojë me sukses, ose të shlyhet.

Kur kredia është ristrukturuar ose modifikuar por nuk është çregjistruar, Banka rivlerëson gjithashtu nëse ka pasur rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë. Banka konsideron nëse aktivet duhet të klasifikohen si Faza 3.

Sapo një aktiv të jetë klasifikuar si i ristrukturuar, ai do të mbetet i ristrukturuar për një periudhë minimale provë 12-mujore. Në mënyrë që huaja të riklasifikohet nga kategoria e ristrukturimeve, klienti duhet të plotësojë të gjitha kriteret e mëposhtme:

- Të gjitha ekspozimet e tij konsiderohen si performuese
- Periudha e provës prej një viti ka kaluar që nga data që kontrata e ristrukturimit konsiderohej si performuese.
- Klienti nuk ka më kontrata që kanë më shumë se 30 ditë vonesa.

Në Segmentin e Kredive Mikro, për një kredi që do të rishkruhet jashtë kategorisë “forborne”, klienti duhet të përmbushë të gjitha kriteret e mëposhtme:

- Të gjitha facilitetet e tij duhet të konsiderohen në performancë.
- Periudha e provës prej 9 muajsh ka kaluar nga data kur kontrata “forborne” u konsiderua në performancë.
- Janë kryer pagesa të rregullta të një shumëje jo të parëndësishme të principalit ose interesit gjatë të paktën gjysmës së periudhës së provës.
- Klienti nuk ka kontrata që janë më shumë se 30 ditë vonë në pagesë.

o) Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Vlera e drejtë është çmimi me të cilin aktivi mund të shitet, ose një detyrim të transferohet, në një transaksion të zakonshëm në tregun kryesor (ose më të favorshëm) në datën e matjes, nën kushtet aktuale të tregut (p.sh. një çmim dalje) pavarësisht nëse ai çmim është direkte i vëzhgueshme ose i vlerësueshëm duke përdorur metodë tjetër vlerësimi. Kur vlerat e drejta të aktiveve dhe detyrimeve financiare të regjistruara në pasqyrën e pozicionit financiar nuk mund të llogariten nga tregjet aktive, ato përcaktohen duke përdorur një shumëllojshmëri teknikash vlerësimi që përfshijnë dhe përdorimin e modeleve të vlerësimit. Inputet në këto modele merren nga tregje të vëzhgueshme ku është e mundur, por kur kjo nuk është e mundur, vlerësimi kërkohet në përcaktimin e vlerave të drejta. Gjykimet dhe vlerësimet përfshijnë konsiderime për likuiditetin dhe inpute të modeleve të lidhura me zëra si rreziku i kredisë (si i veti ashtu dhe i palëve), rregullimet e vlerës së financimit, korrelacionin dhe paqëndrueshmërinë.

p) Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë para në arkë, balanca në Bankën Qendrore të pakufizuara në përdorim dhe aktive financiare shumë likuide me maturim fillestar deri në tre muaj ose më pak nga data e blerjes, të cilat kanë rrezik të pakonsiderueshëm ndryshimi të vlerës së tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka për menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

q) Marrëveshjet e blerjes dhe të riblerjes

Letrat me vlerë të shitura nën një marrëveshje për t'u ri-blerë në një datë specifike në të ardhmen nuk regjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar ndërsa Banka mban në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë. Paratë përkatëse të marra njihen në pasqyrën e pozicionit financiar si një aktiv me detyrimin përkatës për kthimin e tyre, përfshirë interesin e përlogaritur si një detyrim brenda kolateralit të parave mbi letrat me vlerë të lëna dhe marrëveshjet e riblerjes, duke pasqyruar substancën ekonomike të transaksionit si një kredi ndaj Bankës.

Diferenca midis çmimeve të shitjes dhe riblerjes trajtohet si shpenzim i interesit dhe përlogaritet gjatë gjithë jetës së marrëveshjes duke përdorur NEI. Kur kundër pala ka të drejtë të shesë ose të rivendosë letrat me vlerë, Banka i riklasifikon ato letra me vlerë në pasqyrën e pozicionit financiar si letra me vlerë të mbajtura për tregtim të vena si kolateral ose si investime financiare VDATGI të vena si kolateral, siç është e përshtatshme. Në të kundërt, letrat me vlerë të blera të lidhura me marrëveshjen për t'u shitur në një datë të caktuar të ardhshme nuk njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Shuma e paguar, përfshirë interesin e përlogaritur, regjistrohet në pasqyrën e pozicionit financiar, brenda kolateralit të parave të gatshme për letrat me vlerë të huazuara dhe marrëveshjet e riblerjes të anasjellta, duke pasqyruar substancën ekonomike të transaksionit si një kredi nga Banka. Diferenca midis çmimeve të blerjes dhe rishitjes regjistrohet në të ardhurat neto nga interesi dhe është përlogaritur gjatë gjithë jetës së marrëveshjes duke përdorur NEI.

Nëse letrat me vlerë, të blera në bazë të një marrëveshjeje për t'u rishitur, i shiten më pas një pale të tretë, detyrimi për kthimin e letrave me vlerë regjistrohet si një shitje e shkurtër brenda detyrimeve financiare të mbajtura për tregtim dhe matet me vlerën e drejtë me çdo fitim ose humbje të përfshirë në të ardhurat neto nga tregtimi.

r) Qiratë Financiare

(i) *Banka si qiramarrës*

Banka nënshkruan marrëveshje qiraje, kryesisht për ambientet ku zhvillohet aktiviteti, pajisjet dhe mobilitet e lidhura me to, pajisjeve IT dhe automjeteve motorike (megjithëse aktualisht Banka nuk përdor automjete me qira).

Kontratat e qirasë negocohen zakonisht për një kohëzgjatje ndërmjet 1 dhe 5 vjetëve dhe disa prej tyre kanë opsionin e zgjatjes së kohëzgjatjes së kontratës. Banka nuk hyn në marrëveshje të shitjes dhe kthimit të objekteve të marra me qira. Të gjitha qiratë janë negociuar mbi baza individuale dhe përmbajnë një larmi të gjerë të termave dhe kushteve të tilla si; termat e pagesës, mbylljes së kontratës dhe klauzolat e përshkallëzimit.

Banka vlerëson nëse ekziston një kontratë qiraje apo nëse një kontratë aktive përmban një qira në përbërjen e saj. Një qira përcjell të drejtën për të përdorur një aktiv dhe për të marrë të gjitha përfitimet ekonomike të këtij aktivi për një periudhë të caktuar kohore, në këmbim të vlerësimit. Disa kontrata qiraje mund të përmbajnë komponentë qiraje ashtu dhe jo qiraje. Këto komponentë jo të lidhura me qiranë, zakonisht lidhen me shërbimet e menaxhimit të pajisjeve të zyrës si edhe kontratat e servisit dhe riparimit të automjeteve motorike. Banka ka zgjedhur të mos i ndajë komponentët e një kontratë qiraje por këto kontrata llogariten si një komponent i vetëm i qiramarrjes. Për qiratë e tjera të saj, përbërësit e qirasë ndahen në komponentët e qirasë dhe jo të qirasë bazuar në çmimet e tyre relative të pavarura.

Matja dhe njohja e qirave nga qiramarrësi

Në datën e fillimit të qirasë, Banka njeh një të drejtë përdorimi të aktivit dhe një detyrim qiraje në pasqyrën e pozicionit financiar. E drejta e përdorimit të aktivit matet me kosto, i cili përbëhet nga: matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e kryer nga Banka, një vlerësim i çdo kostoje për të çmontuar dhe hequr aktivin në fund të kohëzgjatjes së qirasë dhe çdo pagesë qiraje e bërë para datës së fillimit të qirasë (neto nga çdo pagesë/zbritje e marrë)

Banka zhvlerëson të drejtën e përdorimit të aktivit mbi një bazë lineare nga data e fillimit të qirasë deri në fund të jetës së dobishme të aktivit. Banka gjithashtu vlerëson të drejtën e përdorimit të aktivit për qëllime të zhvlerësimit, kur tregues të tillë ekzistojnë.

Në datën e fillimit, Banka mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të paguara në atë datë, të zbritura duke përdorur normën e borxhit të Bankës ose normën mesatare të tregut të qiradhënies. Norma e borxhit është norma e vlerësuar që Banka do të duhej të paguante për të marrë hua të njëjtën shumë për një njëtin afat, për të përfituar një aktiv me një vlerë ekuivalente me atë të marrë me qira. Kjo normë rregullohet nëse njësia ekonomike e qiradhënësit ka një profili rreziku të ndryshëm në krahasim me atë të Bankës.

Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse, pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shumat që priten të paguhesh nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që dalin nga opsionet të arsyeshme dhe të sigurta për t'u ushtruar.

Pas matjes fillestare, detyrimi do të zvogëlohet nga pagesat e qirasë që janë alokuar ndërmjet ripagimeve të principalit dhe shpenzimeve financiare. Shpenzimet financiare përfaqësojnë shumat që prodhojnë një normë konstante periodike interesi në pjesën e mbetur të detyrimit të qirasë.

Detyrimi i qirasë rivlerësohet kur ka një ndryshim në pagesat e qirasë. Këto ndryshime vijnë nga një ndryshim në afatin e qirasë ose një ndryshim në vlerësimin e një opsioni për të blerë një aktiv

me qira. Pagesat e rishikuara të qirasë zbriten duke përdorur normën e borxhit të Bankës në datën e rivlerësimit, kur norma e nënkuptuar në qira nuk është e mundur të përcaktohet. Shuma e rimatjes së detyrimit të qirasë pasqyrohet si rregullim i vlerës kontabël të së drejtës së përdorimit të aktivit. Përfshirë është kur vlera kontabël neto e së drejtës së përdorimit është reduktuar në zero dhe çdo tepriçë njihet në fitim ose humbje.

Pagesat nën qira mund të ndryshojnë gjithashtu kur ka ose një ndryshim në shumat që priten të paguhesh nën garancitë e vlerës së mbetur ose kur pagesat e ardhshme ndryshojnë përmes një indeksi ose normë të përdorur për të përcaktuar ato pagesa, përfshirë ndryshimet në normat e qirasë në treg pas një rishikimi të tregut të qirasë. Detyrimi i qirasë rimatet vetëm kur rregullimi i pagesave të qirasë ka efekt dhe pagesat e rishikuara kontraktuale për pjesën e mbetur të afatit të qirasë zbriten, përdorur një normë skontimi të pandryshuar. Përfshirë rastet kur ndryshimi në pagesat e qirasë rezultojnë nga ndryshimi i normave të interesit të ndryshueshme, rast në të cilin norma e skontimit ndryshohet për të pasqyruar dhe ndryshimin në normat e interesit.

Për t'iu përgjigjur nevojave të biznesit veçanërisht në kërkesën për hapësirë për zyra, Banka do të hyjë në të negociata me pronarët për të rritur ose ulur hapësirën e disponueshme për zyra ose për të rin negociuar shumat e pagueshme sipas qirave përkatëse. Në disa raste, Banka është në gjendje të rrisë kapacitetin e zyrës, duke marrë në dispozicion hapësira shtesë të lira dhe duke rënë dakord me qiradhënësin për të paguar një shumë që është në përpjesëtim me çmimet e secilës për të pasqyruar kushtet përkatëse të kontratës. Në këto situata, marrëveshja kontraktuale trajtohet si një qira e re dhe llogariten në përputhje me rrethanat.

Në raste të tjera, Banka është në gjendje të negociojë një ndryshim të një kontrate qiraje, si uljen e shumës së hapësirës për zyra, zvogëlimin e afatit të qirasë ose zvogëlimin e shumës totale të pagueshme për qiranë. Këto komponentë nuk ishin pjesë e kushteve origjinale të qirasë. Në këto situata, Banka nuk i konsideron këto komponentë si ndryshime, por i trajton si një kontratë të re qiraje.

Në vend të kësaj, pagesat e rishikuara kontraktuale skontohen duke përdorur një normë të rishikuar të skontimit në datën kur qiraja modifikohet në mënyrë efektive. Për arsye të shpjeguara më sipër, norma e skontimit është norma e borxhit të Bankës e përcaktuar në datën e modifikimit, pasi norma e nënkuptuar në qira nuk është e lehtë për t'u përcaktuar.

Ri-matja e detyrimit të qirasë sjell një zvogëlim të vlerës kontabël të aktivit me të drejtë përdorimi, për të pasqyruar përfundimin e plotë ose të pjesshëm të qirasë për ato modifikime të saj që zvogëlojnë fushëveprimin e qirasë. Çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë njihet në fitim ose humbje. E drejta e përdorimit të aktivit rivlerësohet për të pasqyruar të gjitha modifikimet e tjera të qirasë.

Banka ka zgjedhur të aplikojë përfshirjen për qiratë afatshkurtra dhe qiratë e aktiveve me vlerë të ulët duke përdorur qëllimet praktike. Këto qira kanë të bëjnë me sendet e pajisjeve të zyrës si tavolina, karrige dhe pajisje të caktuara IT. Në vend që të njohin një aktiv me të drejtë përdorimit dhe një detyrim qiraje, pagesat në lidhje me këto qira njihen si një shpenzim periudhe në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

(ii) *Banka si qiradhënëse*

Si qiradhënëse Banka klasifikon qiratë e tij si qira operative ose financiare. Një qira klasifikohet si një qira financiare nëse i transferon të gjitha rreziqet dhe përfitimet tek qiramarrësi.

s) *Aktive afatgjata materiale*

(i) *Njohja dhe matja*

Aktivitet afatgjatë materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë të gjitha shpenzimet të cilat lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e aktivitet. Nëse pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetë të dobishme të ndryshme, atëherë këto pjesë kontabilizohen si zëra të veçanta (përbërësit kryesor) të aktiveve afatgjatë materiale. Çdo fitim ose humbje nga shitja ose nxjerrja jashtë përdorimi i një aktivitet afatgjatë (të llogaritur si diferenca midis të ardhurave neto nga shitja e aktivitet dhe vlerës kontabël të aktivitet) njihet të të ardhurat e tjera në fitim ose humbje.

(ii) *Kosto të tjera pasuese*

Kostot e zëvendësimit të një pjesë të aktivitet njihen me vlerën kontabël të aktivitet nëse është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike që lidhen me këtë aktivitet do të rrjedhin për Bankën dhe nëse kostot e tij mund të maten në mënyrë të besueshme..

(iii) *Amortizimi*

Amortizimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të çdo pjesë të aktivitet afatgjatë material. Trualli dhe veprat e artit nuk zhvlerësohen.

Jeta e dobishme e vlerësuar për periudhën aktuale janë të paraqitura si më poshtë:

	Në vite
• Ndërtesa	20-50
• Mobilje dhe pajisje zyre	5
• Automjete	4-5
• Kompjuterat dhe pajisjet elektronike	4

Aktivitet nuk amortizohen deri në momentin që fillojnë të përdoren dhe transferohen nga aktive në ndërtim apo zhvillim, në kategorinë përkatëse të aktiveve.

E drejta e përdorimit të aktiveve paraqiten së bashku me pronat dhe pajisjet në pasqyrën e pozicionit financiar. E drejta e përdorimit të aktiveve zhvlerësohen metodën lineare gjatë afatit të qirasë dhe jetës së dobishme të vlerësuar të aktiveve.

t) *Aktive afatgjatë jomateriale*

Aktivitet afatgjatë jomateriale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje nga zhvlerësimi. Amortizimi llogaritet duke përdorur metodën lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të aktivitet. Jeta e dobishme e vlerësuar paraqitet si më poshtë:

	Vite
• Programe kompjuterike dhe licenca	4

u) *Aktivitet e mbajtura për qëllime investimi*

IAS 40 "Pronat e investimit" zbatohet për kontabilizimin e pasurive të paluajtshme (tokë dhe/ose ndërtesa) të mbajtura për të gjeneruar të ardhura nga qiratë ose për rritje të vlerës së kapitalit (ose të dyja). Pronat e investimit fillimisht maten me kosto dhe, me disa përjashtime, mund të

maten më pas duke përdorur modelin e kostos ose modelin e vlerës së drejtë, ku ndryshimet në vlerën e drejtë sipas modelit të vlerës së drejtë njihen në fitim ose humbje.

v) Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo financiare të Bankës, të ndryshme nga aktivet tatimore të shtyra dhe inventarët, rishikohen çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ka një tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Humbja nga zhvlerësimi njihet në rast se vlera kontabël e aktivit është më e madhe se vlera e tij e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve i cili gjeneron flukse monetare, të cilat në masë të madhe janë të pavarura nga aktivet e tjera ose grupet e tjera të aktiveve. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të lidhura me njësitë që gjenerojnë flukse monetare janë njohur fillimisht për të pakësuar vlerën kontabël të emrit të mirë të alokuar kësaj njësie gjeneruese të mjeteve monetare dhe më pas për të ulur vlerën kontabël të aktiveve të tjera të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare (grup njësisish gjeneruese të mjeteve monetare), me bazë të ponderuar.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese së mjeteve monetare është më e madhja midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë duke zbritur koston e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuara monetare të ardhshme janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

w) Grante

Një grant njohet në pasqyrën e pozicionit financiar fillimisht si të ardhura të shtyra kur ka siguri të arsyeshme që do të merret dhe që Banka do të përmbushë kushtet e bashkangjitura. Grantet që kompensojnë Bankën për shpenzimet e kryera njohën si të ardhura në pasqyrën e fitimit dhe humbjes në një mënyrë sistematike gjatë të njëjtave periudha kur shpenzimet kryhen. Grantet që kompensojnë Bankën për koston e një asemi njohën si të ardhura në pasqyrën e fitimit dhe humbjes në mënyrë sistematike gjatë jetës së dobishme të asetit ose pas përfundimit të kushteve kontraktuale të bashkangjitura.

x) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarje në të kaluarën, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv dhe ka të ngjarë të ketë një dalje të burimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe aty ku është e përshtatshme, edhe rreziqe specifike ndaj detyrimit. Shpenzimet lidhur me çdo provizion prezantohen në pasqyrën e të ardhurave neto nga çdo rimbursim në shpenzime të tjera operacionale.

y) Përfitimet e punonjësve

Banka paguan vetëm kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore, të cilat përfitohen nga punonjësit pas daljes në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributesh të përcaktuar. Kontributet e Bankës për planin e pensionit ngarkohen në fitim ose humbje në momentin kur ato ndodhin.

Informacione plotesuese:

Banka Amerikane e Investimeve Sh.a. ("Banka" ose "American Bank of Investments" ose "ABI"), është një filial në pronësi të plotë i Tranzit Sh.a., një institucion financiar jobankar shqiptar në pronësi të Moscopole Inc., me z. Andi Ballta si përfutues përfundimtar, si dhe New Century Holdings XI, LP dhe NCH Fund, L.P.

ABI operon në Shqipëri në bazë të një licence bankare të lëshuar nga Banka e Shqipërisë dhe ofron një gamë të plotë shërbimesh bankare për klientët korporatë dhe individë. Banka operon në përputhje me Ligjin nr. 9662 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", datë 18 dhjetor 2006 dhe është e licencuar për të kryer aktivitete kredidhënieje dhe depozitash, shërbime pagesash për rezidentë dhe jorezidentë, si dhe aktivitete të tjera bankare në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Banka zotëron 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërive "ABI Invest Sh.a." dhe "ABI Broker Sh.a.", të cilat operojnë përkatësisht në tregjet e investimeve dhe sigurimeve, të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve më 22 dhjetor 2020 dhe 10 janar 2019. Për më tepër, që nga Marsi 2026, Banka zotëron 60% të kapitalit aksionar të "I.F.J.B. NOA Sh.a." në Kosovë, një institucion financiar jobankar i licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës, i cili më parë ishte në pronësi të NOA Sh.a. para bashkimit të saj me Bankën (shënimi 18)

Banka është themeluar fillimisht në Shqipëri në tetor 1998 si Intercommercial Bank – Albania Sh.a., një filial i Commercial Bank of Greece. Më pas, Banka ka operuar nën disa emra, përfshirë Commercial Bank of Greece (Albania) Sh.a., Emporiki Bank Albania Sh.a. dhe Crédit Agricole Bank Albania Sh.a.

Në tetor 2015, Tranzit Sh.a. bleu 100% të aksioneve të Bankës nga Crédit Agricole Group. Pas këtij blerjeje dhe miratimeve nga organet rregullatore, Banka ndryshoi emrin e saj në Banka Amerikane e Investimeve Sh.a. Gjatë periudhës 2015–2018, Banka vijoi rritjen organike dhe aktivitetin normal të biznesit, kryesisht të fokusuar në kreditim.

Më pas, në korrik 2018, Banka përfundoi blerjen e Banka NBG Albania Sh.a., dhe të dy entitetet u bashkuan ligjërisht më 1 tetor 2018, me Bankën Amerikane të Investimeve Sh.a. si entiteti mbijetues. Gjatë vitit 2019, të dy entitetet arritën të përfundojnë me sukses bashkimin teknik, duke siguruar operacione të unifikuara dhe aktivitet biznesi të përqendruar.

Në vijim të strategjisë së zgjerimit, më 27 nëntor 2025, Banka Amerikane e Investimeve Sh.a. ("ABI Bank") dhe NOA Sh.a. u bashkuan ligjërisht përmes përthithjes së NOA Sh.a. nga ABI si entiteti mbijetues. Kushtet dhe termat e bashkimit u miratuan nga aksionarët më 25 nëntor 2025, në përputhje me miratimin paraprak rregullator të marrë më 5 nëntor 2025, sipas Vendimit nr. 61 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, me njoftimin e marrë më 21 nëntor 2025. NOA ishte një institucion mikrofinanciar jobankar i licencuar nga Banka e Shqipërisë dhe i blerë nga aksionarët e ABI më 31 dhjetor 2024.

Sipas statutit të ri dhe miratimit të aksionarëve, kapitali i paguar u bashkua ndërmjet ABI dhe NOA, duke rritur vlerën nominale për aksion, ndërkohë që numri i aksioneve nuk ka ndryshuar. Më 31 dhjetor 2025, kapitali aksionar i regjistruar i ABI raportoi në Lekë shqiptarë (ose "LEK") 4,182,773 mijë (2024: LEK 3,450,935 mijë), i përbërë nga 84,769 aksione me një vlerë nominale prej LEK 49,343.2.

Selia e regjistruar e Bankës ndodhet në Tiranë, në "Rruga e Kavajës", Ndërtesa nr. 27, H1, kati i 8-të. Banka operon vetëm në Shqipëri, me një rrjet prej 59 degësh më 31 dhjetor 2025 (2024: 27 degë).

Pas bashkimit, Banka raporton një total prej 802 punonjësish më 31 dhjetor 2025 (2024: 436), nga të cilët 416 janë punonjës të Zyrës Qendrore (2024: 275).

2. politikat e zbatuara të kontabilitetit , si paraqitur ne shenimet me siper.

3. Per reference shënimi 33 ne kapitullin pasqyrat financiare te Raportit Vjetor.
4. Vlera e huave dhe paradhënieve të ofruara për anëtarët e organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse, per reference shënimi 36 ne kapitullin pasqyrat financiare te Raportit Vjetor.
5. Banka nuk ka regjistruar të ardhura apo shpenzime të pazakonta për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2025.
6. Vlera e detyrimeve te Bankes që kanë afat shlyerjeje mbi pesë vjet eshte 24,204,116 mije LEK, per reference shenimi 5(b) kapitulli Pasqyrat Financiare te Raportit vjetor.
7. Numri mestar I punonjesve te gjate vitit 2025 ka qene 802 punonjes.
9. Ne lidhje me shpërblimet e dhëna për vitin ushtrimor anëtarëve të organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse, informacioni gjendet ne shenimin 36 te kapitullit pasqyrat financiare te Raportit Vjetor.
10. Ne lidhje me shpenzimet e personelit te vitit 2025 informacioni ne shenimin 30 te kapitullit pasqyrat financiare te Raportit Vjetor.
11. Institucioni nuk njeht provigjionim për tatimin e shtyrë.
12. Banka zotëron pjesëmarrje në institucionet e mëposhtme:
- ABI Broker sh.a me kapital neto ne fund te vitit 2025 me vlere 19,143,135 LEK, fitimi I vitit 15,227,649. Me seli Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, Hyrja 1, Njësia Bashkiake 10, Kodi Postar 1001, Tirane, Shqipëri. ABI SH.A zotëron 100% të aksioneve të ABI Broker SH.A
 - ABI Invest me kapital neto ne fund te vitit 2025 me vlere 29,430,487 LEK, fitimi i vitit 2,663,491 LEK. Me seli Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, Hyrja 1, Njësia Bashkiake 10, Kodi Postar 1001, Tirane, Shqipëri. ABI SH.A zotëron 100% të aksioneve të ABI Invest SH.A
 - IFJB NOA sh.a Kosove me kapital neto ne fund te vitit 2025 me vlere 305,806 EUR, Humbja e vitit 219,446 EUR. Me seli ne rrugen Rr Perandori Justinian, Prishtine Kosove me NUI: 811987968. ABI SH.A zotëron 60% të aksioneve të I.F.J.B NOA SH.A
 - Bursa Shqiptare e Titujve ALSE sh.a., ABI SH.A zotëron 45.59% të aksioneve
 - Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG sh.a, ABI SH.A zotëron 47.5% të aksioneve
13. Nuk eshte e aplikueshme.
14. Nuk eshte e aplikueshme.
15. Lidhur me investimet ne tituj , informacioni gjendet ne shenimin 18 te Kapitullit Pasqyrat financiare te Raportit Vjetor.
16. Referoju pikes 12 me siper per emrin, seline e regjistruar dhe forma juridike te çdo shoqërie ku Banka është anëtar me përgjegjësi të pakufizuara.

17. Pasqyrat financiare te konsoliduara perгатiten nga kompania mēmē Tranzit Sh.A me Seli të regjistruar në adresën Qendra e Biznesit G-Kam, Ndertesa 1, Kati 5, Njesia Postare 10, Kodi Postar 1001.

18. Referoju pikes 17me siper.

19. Kopje te pasqyrave financiare te konsoliduara per vitin 2025 do te jene te publikuara ne faqen e web-it, <https://abi.al/c/46/pasqyra-financiare>

21. Nuk eshte e aplikueshme.

22. Informacioni gjendet ne shenimin 33 te Kapitullit Pasqyrat financiare te Raportit Vjetor.

23. Të ardhurat gjenerohen në Shqipëri, të ardhurat e gjeneruara në Kosovë përfaqësojnë më pak se 1% të totalit të të ardhurave të Bankës.

24. Tarifa e auditimit për pasqyrat financiare të ABI Bank për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2025 eshte 6,350 mijë ALL, e cila përfshin edhe auditimin e pasqyrave financiare të NOA sh.a. për periudhën deri më 26 nëntor 2025.